

FINANCA

Ditari Mujor | Qershor 2024



KËSHILLI I MINISTRAVE MIRATON VENDIMET PËR RITJEN E PAGAVE NË SEKTORIN PUBLIK

Këshilli i Ministrave miratoi në mbledhjen e datës 26 qershor vendimet për detajimin e rritjes së pagave në sektorin publik. Në komunikimin me mediat pas mbledhjes, Ministri i Financave informoi se me miratimin e vendimeve avancohet faza e dytë e politikës së rritjes së pagave, e cila ka nisur në vitin 2023, fazë nga e cila përfitojnë rreth 135 mijë punonjës të administratës shtetërore. Ministri theksoi faktin se me zbatimin e kësaj politike paga mesatare në sektorin publik synohet të arrijë në 105 mijë Lekë. Rritja e parashikuar do nisë të

aplikohet nga data 1 korrik 2024, me një kosto të përlogaritur prej afro 11 miliardë lekësh për 6 mujorin e dytë të vitit dhe me një kosto totale buxhetore prej afro 40 miliardë lekësh, duke filluar nga viti 2025. Nga politika e rritjes së pagave do të përfitojnë: punonjësit e sistemit arsimor parauniversitar; punonjësit e sistemit shëndetësor; punonjësit e sistemit të sigurisë së vendit (Policia e Shtetit, Policia e Burgjeve, Garda e Republikës, Forcat e Armatosura, Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi); si edhe punonjësit e nivelit zbatues dhe mbështetës të administratës shtetërore.

LEXO MË SHUMË

MIRATOHET "STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË FINANCIVE PUBLIKE" DERI NË 2030

Këshilli i Ministrave miratoi në mbledhjen e datës 12 qershor "Strategjinë e Menaxhimit të Financive Publike", e cila ka në fokus marrjen e masave në funksion të forcimit të mëtejshëm të Financive Publike, deri në vitin 2030. Dokumenti iu nënshtrua fillimit procesit të konsultimit publik nga Ministria e Financave dhe është dakordësuar edhe me Bashkimin Europian, në kuadër të

procesit të integritimit në BE. Masat e parashikuara kategorizohen në gjashtë shtylla kryesore, të cilat kanë të bëjnë me programimin makroekonomik dhe monitorimin e riskut, planifikimin e integruar strategjik dhe buxhetor, menaxhimin dhe mobilizimin e të ardhurave, kontabilitetin dhe menaxhimin e zbatimit të buxhetit, kontrollin e brendshëm financiar publik, si edhe mbikëqyrjen

e jashtme. Referuar të ardhurave, synohet rritja e mobilizimit të tyre përmes zhvillimit dhe zbatimit të politikave të avancuara tatimore, përmirësimi i mëtejshëm i sistemeve të menaxhimit të taksave, si edhe modernizimi i sistemeve të menaxhimit të riskut të administratës doganore, në përputhje edhe me kërkesat e BE-së.

LEXO MË SHUMË



Ministri Mete takon Presidentin e Mastercard Europe, diskutohet mbi rritjen e pagesave digjitale

Ministri i Financave, Ervin Mete, priti në një takim Presidentin e kompanisë Mastercard për Europën, Mark Barnett, me të cilin bisedoi mbi zhvillimet në drejtim të digjitalizimit dhe pagesave elektronike në vendin tonë, ku në vitet e fundit është vërejtur një trend pozitiv në këtë aspekt. Bisedimet u përqendruan edhe mbi mundësitë e rritjes së prezencës së Mastercard në Shqipëri. Bazuar në të dhënat e analizuar nga Mastercard lidhur me fluturimet e programuara për periudhën qershor-gusht 2024, Tirana rezultoi destinacioni i tretë më i preferuar në Botë, pas Mynihut dhe Tokios. Në këtë drejtim, Presidenti i Mastercard Europe shprehu interesin e kompanisë për të bashkëpunuar me qeverinë shqiptare, duke e vlerësuar Shqipërinë si një treg me potencial të lartë në rajon sa i përket digjitalizimit dhe në veçanti rritjes së pagesave elektronike.

LEXO MË SHUMË

Performanca Paraprake e të Ardhurave dhe Shpenzimeve për periudhën Janar-Maj 2024

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Maj 2024 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale, për periudhën 5-mujore arritën në rreth 287.1 miliardë lekë ose 103.4% e planit të së njëjtës periudhë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, u mbledhën rreth 29 miliardë lekë më shumë, ose 11.2% më shumë se pesë-mujori i vitit 2023. Të ardhurat e arkëtuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (përfshirë edhe Kontributet e mbledhura nga DPT) arritën në 247 miliardë lekë, 22.8 miliardë lekë ose 10.2% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, si dhe 4.9 miliardë lekë ose 2% më shumë se plani 5-mujor për vitin 2024. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 5 mujore të vitit 2024, arritën në rreth 236.6 miliardë lekë me një realizim në masën 93.8 përqind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 ato rezultojnë 6.4 përqind më të larta ose rreth 14.3 miliardë lekë më shumë.

LEXO MË SHUMË

Miratohet Kuadri i rishikuar Makroekonomik e Fiskal 2025-2027

Këshilli i Ministrave miratoi në mbledhjen e datës 19 qershor Kuadrin e rishikuar Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2025-2027, përgatitur nga Ministria e Financave, i cili përcakton përparësitë strategjike të qeverisë, projektin pritshmërinë makroekonomike në afatmesëm, si dhe parashikon nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e shtetit. Dokumenti përmban objektivat në lidhje me treguesit kryesorë të politikës fiskale si balancën e përgjithshme fiskale (deficitin), huamarrjen, borxhin publik, si edhe balancën fiskale primare. Konsolidimi fiskal do të vijojë të jetë objektiv i politikës fiskale për periudhën afatmesme 2025-2027, në funksion të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, borxhi publik parashikohet të zbrësë në 55.2% në vitin 2027, ndërsa balanca primare, e rikthyer në pozitive që në vitin 2023, do të vijojë të jetë e tillë, në përputhje edhe me rregullat fiskale të Ligjit Organik të Buxhetit. Sipas projeksioneve, në vitin 2024 të ardhurat totale pritet të shënojnë një rritje të konsiderueshme duke arritur për herë të parë në 28.8% të PBB-së, ose 1% më shumë krahasuar me vitin 2023, ndërsa projektohet të arrijnë në 29.1% të PBB-së në vitin 2027.

LEXO MË SHUMË

Zbatimi i suksesshëm i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, takim mes MF dhe delegacionit të Ministrisë së Financave të Marokut dhe Gjeorgjisë



Zv.Ministrja e Financave, Adela Xhemali dhe drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave zhvilluan një takim me një delegacion të Ministrisë së Financave të Mbretërisë së Marokut dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Gjeorgjisë. Gjatë takimit, delegacioni u njoh me punën e bërë nga Ministria e Financave, me mbështetjen e UN Women në Shqipëri, në ngritjen e një kuadri ligjor dhe institucional të qëndrueshëm në kuadër të integritetit gjinor në politika e buxhete në të gjitha nivelet e qeverisë. Në mënyrë të veçantë, u theksua metodologjia e etiketimit dhe gjurmimit gjinor që Shqipëria përdor, si një prej metodologjive më të mira të aplikuara edhe nga vendet më të zhvilluara në kuadër të zbatimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor. Delegacioni po zhvillon një vizitë studimore në vendin tonë, me ftesë të Ministrisë së Financave dhe zyrës së UN Women në Shqipëri, qëllimi i së cilës është shkëmbimi i eksperiencës së suksesshme të Shqipërisë në zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

LEXO MË SHUMË

